

SHQIPËRIA DHE ANËTARËSIMI I SAJ  
NË BANKËN BOTËRORE

---

**Franco Passacantando**  
**Drejtor Ekzekutiv**  
**Grupi i Bankës Botërore**

**10-VJETORI I ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BANKËN BOTËRORE:**

## REZULTATET E ARRITURA, PËRVOJA E FITUAR<sup>3</sup> nga Franco Passacantando<sup>4</sup>

### PREZANTIMI

Është një nder i madh për mua që marr pjesë në këtë konferencë ndërmjet shumë miqve shqiptarë dhe ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar.

Më lejoni të falenderoj organizatorët e kësaj konference, dhe në veçanti Kryeministrin Ilir Meta dhe Guvernatorin Shkëlqim Cani, që në dhjetëvjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, më krijuan mundësinë, që të diskutoj për çfarë është arritur në këto dhjetë vitet e bashkëpunimit ndërmjet Bankës Botërore dhe Shqipërisë si dhe sfidat e kaluara.

Kjo konferencë zhvillohet në një kohë kur opinioni publik, hartuesit e politikave dhe bota akademike janë duke ndjekur nga afër se si po vepron Banka Botërore si dhe ndikimin e saj në zhvillim. Është e kotë të them, që opinioni që tërheq më shumë vëmendje është ai i kritikëve.

Ata shpesh pretendojnë se vlerat që gjeneron banka nuk justifikojnë paratë që donatorët dhe aksionerët kanë investuar në të apo që politikat e ndjekura nga banka dëmtojnë të varfërit dhe rrisin padrejtësitë sociale.

Unë mendoj se rasti i Shqipërisë është një shembull i mirë që e kundërshton këtë opinion. Ky është një vend që u bë pjesëtar i institucioneve të Bretton Woods pas më shumë se katër dekadave të izolimit dhe në veçanti të regjimit autoritar komunist. Një vend që kishte një eksperiencë fillestare shumë të vogël për instrumentet dhe rregullat e ekonomisë së tregut. Një vend që ka kaluar nëpërmjet një transformimi të shpejtë, i cili shkaktoi rritje të tensioneve sociale të mprehta.

Një vend që qëndron në një nga rajonet më të vështira të botës. Tani sikurse do të paraqitet, Shqipëria ka qenë në gjendje të fitojë

---

<sup>3</sup> Fjalimi i paraqitur në konferencën "Shqipëria ndërmjet reformave të brendshme dhe integritimit European" e organizuar nga Këshilli i Ministrave dhe nga Banka e Shqipërisë ( Tiranë, Shqipëri dhjetor 6-7, 2001).

<sup>4</sup> Autori kërkon të falenderojë Kristaq Lunikun, për mendimet e tij shumë të vlefshme në përgatitjen e këtij materiali dhe Luisa Masutti për komentet e dobishme.

asistencën e plotë të Bankës Botërore dhe të përfitojë prej saj. Kjo nuk do të thotë që çdo gjë ka funksionuar në rregull. Gabime janë bërë dhe, në shumë fusha, progresi është ndërprerë. Por, në përgjithësi, anëtarësimi i Shqipërisë në Bankën Botërore ka kontribuar pozitivisht në zhvillimin e këtij vendi.

#### **NJË PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT TË BANKËS BOTËRORE**


Historiku i lidhjes së Bankës me Shqipërinë paraqitet në aneksin 1, ku fillimisht është analizuar periudha nga viti 1991<sup>5</sup> deri më vitin 1996, kur u zhvilluan reformat e para për të krijuar një ekonomi tregu dhe kur u arrit stabiliteti makroekonomik pas krizës së vitit 1992. Më pas tregohet se si Banka Botërore mbështeti Shqipërinë për të kaluar krizën e vitit 1996, nga rënia e skemave piramidale, dhe krizën e vitit 1999, kur Shqipëria duhet të përballonte një fluks të madh të shpërngulurish nga Kosova. Në fund, aneksi tregon se si Banka Botërore, duke marrë në konsideratë eksperiencën e viteve të para të njohjes me Shqipërinë, riorientoi strategjinë e saj, duke shoqëruar iniciativat për të nxitur më tej rritjen e sektorit privat me një program për të forcuar qeverisjen, përgjegjshmërinë dhe eficiencën e institucioneve publike, së bashku me një vëmendje të madhe mbi problemet shoqërore.

Në dhjetë vjet Grupi i Bankës Botërore, nëpërmjet IDA, ka miratuar 42 hua dhe ka përfunduar 22 projekte. IDA ka lëvruar në total 392.4 milionë dollarë, që do të thotë një mesatare prej 114 dollarësh për çdo shqiptar. Banka Botërore luan një rol të rëndësishëm brenda komunitetit të donatorëve, meqenëse fondi i përgjithshëm i dhënë paraqet rreth 18 për qind të asistencës totale zyrtare dhënë Shqipërisë nga komuniteti i donatorëve që nga viti 1991. Pjesa më e madhe e lëvrimeve janë bërë për huatë e rregulluara, por kjo është kryesisht nëpërmjet operacioneve në vitet 1998 dhe 1999 (shiko tabelën II.3 në aneksin II) në vitet e tjera sektorët kryesorë ishin infrastruktura dhe bujqësia.


Huatë për asistencën teknike kanë luajtur, gjithashtu, një rol të rëndësishëm, në të dyja rastet si në fillimin e dekadës dhe në vitin fiskal 2000, kur Banka Botërore i përqendroi përpjekjet e saj në krijimin e institucioneve.

---

<sup>5</sup> Shqipëria u bë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e grupit të Bankës Botërore në tetor të vitit 1991, duke u bashkuar me lidhjen e cila përbëhej nga Italia, Portugalia, Malta dhe San Marino.



Sikurse e tregon dhe grafiku në vazhdim, mbështetja për Shqipërinë ka qenë pa ndërprerje, me përjashtim të krizës së vitit 1997, kur nuk u miratua asnjë hua e re, dhe ka arritur maksimumin në vitin 1999, gjatë krizës së Kosovës, ku fondet e angazhuara arritën maksimumin me 125 milionë brenda një viti. Për më shumë se 10 vjet të hyrjes së IDA-s në Shqipëri, sasia e akorduar për frymë është rritur shumë nga 12 dollarë në vitin 1992, në rreth 23 dollarë në vitin 2000.



#### **DUKE VLERËSUAR REZULTATET E ARRITURA**

Ne tani mund t'i kthehemi pyetjes se çfarë është arritur nga Banka Botërore me programin e saj në Shqipëri. Çfarë rezultatesh mund t'u tregohen donatorëve për të vërtetuar që 400 milionë dollarë, që ata kanë dhënë për Shqipërinë në 10 vjet, janë shpenzuar si duhet? Dhe rezultatet mund t'u tregohen shqiptarëve për të vërtetuar se programet e Bankës Botërore janë të vlefshme në lidhje me pengesat e tanishme dhe, të së ardhmes me të cilat ata

mund të përballohen, duke e parë në kuadrin e kushteve që duhet të përmbushen dhe të borxheve që duhen shlyer. Fatkeqësisht, nuk mund të jepet një përgjigje e lehtë për këto pyetje. Disa rezultate të prekshme janë të dukshme në rregullimet e rrugëve, në kanalet ujitëse, në shkolla dhe në spitale. Por, sot Banka Botërore beson se ajo që ka më tepër rëndësi për zhvillim, përveç infrastrukturës dhe kapitalit fizik, janë ligjet, rregullat dhe institucionet e një vendi, si dhe cilësia e kapitalit human dhe social.

Duke ndjekur më nga afër rezultatet në këtë fushë, matja do të ishte veçanërisht komplekse. Gjithashtu, është shumë e vështirë të ndash kontributin specifik të Bankës Botërore prej atyre të donatorëve apo të agjencive, ose prej kontributit që ka dhënë vetë Qeveria Shqiptare, e pavarur nga institucionet ndërkombëtare. Por, gjithësesi, është e mundur të identifikohen disa fusha ku Banka Botërore ka qenë më e suksesshme, aty ku janë shfaqur problemet dhe janë kapërcyer sfidat më të mëdha. Unë do të përqendrohem në tre fusha: nxitja e veprimtarisë së sektorit privat, institucionet dhe qeverisja, zhvillimi njerëzor dhe shoqëror.<sup>6</sup>

#### **NXITJA E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT PRIVAT**

Një nga arritjet kryesore të dekadës së kaluar duket në nxitjen e një sektori privat aktiv në bujqësi dhe në fushat e sipërmarrjeve të bizneseve të vogla. Megjithëse Shqipëria reagoi në pjesën më të madhe me nismën e vet, për të mënjanuar shtetin nga aktivitetet prodhuese, Banka Botërore ka kontribuar shumë në këtë proces, sidomos në gjysmën e dytë të dekadës së fundit. Më 1997, 92 për qind e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në prodhimin bujqësor dhe në biznesin e marketingut bujqësor ishin privatizuar plotësisht.

U krijuan rreth 450,000 ferma me një madhësi mesatare prej 1.1 hektarësh. Gjithashtu, falë përmirësimeve në sistemin ujitës, madhësia e vlerës së produktit bujqësor, me çmime konstante, u rrit me 57 për qind nga viti 1991 në vitin 1995. Një nga projektet më të suksesshme, që gjithashtu kontribuoi në këto zhvillime në bujqësi, ka qenë programi i kreditimit rural (të fshatrave). Në vitin 1996, u shitën 7,500 shoqëri të vogla. Privatizime të rëndësishme u kryen në miniera, në sektorin e telekomunikacionit si dhe në sektorin bankar.

---

<sup>6</sup> Një vlerësim i pavarur i programit të Bankës Botërore është i disponueshëm në Bankën Botërore, Departamenti i Vlerësimit të Operacioneve, Shqipëri, vlerësimi i asistencës së vendit, Washington D.C, 16 nëntor 2000.

Është e panevojshme të thuhet se, progresi në shumë fusha është ende i pabarazuar dhe tashmë janë për t'u marrë hapa të rëndësishëm. Kanë filluar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën e portit dhe të rrugëve, por për të favorizuar investimet private duhet të zhvillohet më intensivisht sistemi i përgjithshëm i *transportit*. Në sektorin *energjitik dhe të ujit* janë ende të nevojshme reforma rrënjësore, si dhe përmirësimi i menjëhershëm në administrimin e dobishmërisë së shoqërive. IDA ka bërë përpjekje për të krijuar një *sektor financiar* të përdorshëm dhe të përshtatshëm, por mundësia e përdorimit të financimeve afatgjata është ende e kufizuar. Privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe legjislati i ri për aktivitetin bankar, i cili u përgatit me asistencën e Bankës Botërore, do të jenë një hap i rëndësishëm për krijimin e një sistemi financiar modern. I një rëndësie të madhe do të jetë krijimi i ndërmjetësve financiarë si për shembull, i shoqërive të qirave.

Përmirësimet në të gjitha këto fusha janë të nevojshme për të vazhduar punën e mirë të bërë në hapat e parë të liberalizimit ekonomik. Problemet e sotme janë më komplekse se ato të përballuara në fazat e para të procesit të liberalizimit, por ato kanë nevojë të drejtohen në mënyrë agresive, nëse Shqipëria dëshiron të tërheqë investimet e huaja direkte dhe të diversifikojë ekonominë e saj, që ende është shumë e varur nga sektori i bujqësisë dhe i ndërtimit.

#### **KRIJIMI I INSTITUCIONIT DHE QEVERISJA**

Kjo ka qenë një nga përparësitë në strategjinë e ndjekur nga Banka Botërore me autoritetet shqiptare, në pjesën e dytë të viteve '90. Një nga arritjet më të mëdha ka qenë krijimi i Bankës së Shqipërisë, me kontributin e Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Koncepti i bankës qendrore, që do të kontrollonte paranë dhe do të mbikëqyrte institucionet financiare, ishte krejt i ri, kur Banka e Shqipërisë filloi veprimtarinë e saj në një zyrë të vogël dhjetë vjet më parë. Sot banka është një institucion i mirëstrukturuar dhe i respektuar, falë kurajos dhe punës këmbëngulëse të punonjësve të saj profesionalë nën udhëheqjen e guvernatorëve Vrioni, Luniku dhe Cani. Procedurat dhe instrumentet e politikës monetare janë përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Edhe pse mund të ketë ende vend për përmirësime thelbësore në drejtim të mbikëqyrjes bankare apo në sistemin e pagesave, ka arritje të mëdha, duke sjellë rezultate të dukshme në kuadrin e qëndrueshmërisë monetare dhe të kurseve të këmbimit,

të cilat kanë qenë boshti orientues në udhëheqjen e vendit në rrugën e rimëkëmbjes pas përballimit me kriza të shumta.

Këto arritje në politikën monetare janë shoqëruar me arritje po kaq të rëndësishme në politikën e buxhetit, falë përmirësimeve kryesisht në vjeljen e të ardhurave dhe në forcimin e administratave doganore dhe tatimore. Në anën e shpenzimeve publike, zhvillimi i një kuadri shpenzimesh afatmesme ka ndihmuar dukshëm në identifikimin e një mekanizmi për të zgjedhur shpenzimet prioritare. Ministri Malaj dhe ministri Angjeli dhe punonjësit e tyre kanë arritur këto rezultate në rrethana veçanërisht të vështira. Sfida më e madhe qëndron akoma. Të ardhurat e buxhetit kanë nevojë të rriten edhe më tepër. Baza e tatimeve duhet të shtrihet më shumë. Borxhi publik, edhe pse i administrueshëm, duhet të mbikëqyret më nga afër dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Një drejtim të cilit Banka Botërore i ka kushtuar vëmendje në rritje këto kohët e fundit është reforma ligjore dhe gjyqësore si dhe reforma e administratës publike. Dy projekte të miratuara nga Bordi i Bankës Botërore në mars të vitit 2000, do të asistojnë Shqipërinë në këto dy drejtime të një rëndësie thelbësore për klimën investuese dhe për cilësinë e shërbimeve publike në përgjithësi. Në të kaluarën, dështimi i programit për të zhvilluar një reformë në shërbimet civile, çoi në një largim të shpejtë të punonjësve cilësorë nga administrata publike, duke krijuar kështu një mosbesim ndaj institucioneve publike. Një zbatim i shpejtë i ligjit për falimentimin e bankave dhe të të drejtave të kreditorit mund të sjellë një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një klime investuese të favorshme.

Asnjë reformë në administratën publike nuk mund të jetë e suksesshme, në qoftë se nuk është e shoqëruar nga një vendim i fortë për të luftuar korrupsionin, trafikun ilegal, pastrimin e parave dhe çdo formë tjetër të financimit të terrorizmit dhe të krimit të organizuar. Banka Botërore filloi bashkëpunimin me Shqipërinë rreth problemit të korrupsionit që në vitin 1997. Një vit më vonë, rezultatet e një vëzhgimi të njësive private dhe publike, i cili tregonte se sa të përhapura ishin praktikatat e korrupsionit në Shqipëri, u paraqitën në një workshop të organizuar nga Banka Botërore me Qeverinë. Më pas, Banka Botërore ka asistuar Qeverinë me asistencë teknike të Grupit Drejtues Antikorrupsion të Qeverisë. Banka Botërore po siguron përkrahje për antikorrupsionin nëpërmjet reformave të nisura për administratën publike dhe projekteve për reformat gjyqësore. Puna antikorrupsion për Shqipërinë është vënë në rrugë të drejtë nga

nisma e IAPS (Iniciativa Antikorrupsion e Paktit të Stabilitetit). Banka është anëtare e komitetit drejtues të IAPS.

#### **ZHVILLIMI NJERËZOR DHE SHOQËROR**

Edhe pse Shqipëria ka arritur stabilitetin makroekonomik dhe ka ndërmarrë reforma strukturore të rëndësishme, varfëria vazhdon të jetë akoma më e larta në Europë dhe në gjithë rajonin e Europës Juglindore. Rreth 20 për qind e popullatës është e varfër dhe 90 për qind e tyre jetojnë në zonat rurale në fshat. Varfëria është e lidhur ngushtë me arsimimin e keq dhe me vështirësitë në pranimin e shërbimeve bazë. Në të dyja drejtimet është bërë shumë, por sukcesi ka qenë më shumë i paqëndrueshëm. Fokusimi strategjik mbi rehabilitimin e shkollave ishte i përshtatshëm në vitet e para të asistencës së IDA –s, dhe një program me të vërtetë i mirë rehabilitimi u krye nga viti 1993 deri në vitin 1996. Por, aktualisht, burimet e shpërndara për shëndetësinë dhe arsimin janë të rralla dhe reformat institucionale janë të pakompletuara.

Një fushë në të cilën rezultatet kanë qenë të shkëlqyera, ka qenë përfshirja e komunitetit lokal dhe e organizatave të shoqërisë civile në krijimin e projekteve dhe në zbatimin e tyre. Disa prej projekteve më të suksesshme në fakt ishin ato, të cilat kishin disa forma të përfshirjes së komunitetit. Në projektet rurale dhe në ato ujtitëse, u krijuan asistencë frytdhënëse, si për shembull Fondi i Kreditit për Fshatin ose Shoqata e Përdoruesve të Ujit. Kredia me prejardhje nga projekti rural ka shënuar një shlyerje prej 100 për qind. Kjo ka çuar në një rritje të të ardhurave të familjeve të varfëra nga 15 deri në 70 për qind dhe nga 30 deri në 50 për qind për familjet me të ardhura më të larta<sup>7</sup>. Sikurse del qartë dhe nga vlerësimet e OED për Shqipërinë, projektet e zbatuara nga Banka Botërore tek popullsia lokale kanë zvogëluar dukshëm pasojat e krizave sociale. Në vitet 1990 –2001, rrjeti ujtitës, së bashku me pjesë të tjera të infrastrukturave në zonat rurale, u shkatërruan gjerësisht. Në vitin 1997, përkundrazi, anëtarët e shoqatës së përdorimit të ujit i mbrojtën këto gjatë goditjeve sociale që ndodhën mbas rënies së skemave piramidale, duke minimizuar çdo dëmtrim.

#### **PËRVOJAT E FITUARA**

Në përfundim, dhjetëvjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në Bankën Botërore ka sjellë rezultate shumë të rëndësishme në disa fusha.

---

<sup>7</sup> OED raportimi mbi Shqipërinë, faqe 40.

Megjithëse mbetet akoma shumë për të bërë, çfarë është arritur deri tani nuk duket që të mbështesë pikëpamjen se Asistenca Teknike për Zhvillim, e përfaqësuar nga Banka Botërore, nuk gjeneron të ardhura ose të mund të dëmtojë vendet përfituese. Në të njëjtën kohë unë mendoj që bashkëpunimi i Bankës Botërore me Shqipërinë dhe përvoja e fituar na kanë dhënë mësim shumë të rëndësishme, të cilat unë do të doja t'i përmbledhja shkurtimisht për të përfunduar këtë fjalim.

Mësimi i parë është që stabiliteti makroekonomik dhe reformat pro tregut janë të nevojshme, ndoshta kushte të domosdoshme, por jo të mjaftueshme. Një inflacion i ulët dhe një monedhë e fortë kanë mbrojtur vendin nga ngjarjet *shock* të jashtme. Për shembull, Shqipëria u ndikua minimalisht nga kriza aziatike dhe, gjithashtu, e mori veten shumë shpejt nga kriza e Kosovës. Por, një ecuri përgjithësisht e mirë makroekonomike dhe një rritje e shpejtë nuk bëhen pengesë për pjesën më të madhe të shqetësimeve sociale. Një nga ngjarjet më delikate ishte përvoja e vitit 1997, dhe mund të ketë krijuar në atë kohë një ndjenjë vetkënaqësie, e cila solli anulimin e veprimeve në fushën strukturore dhe sociale.

Mësimi i dytë është që investimet në kapitalin njerëzor dhe ndjekja me vëmendje e problemeve sociale dhe shoqërore janë të një rëndësie të madhe. Ky fakt është i vërtetë në të dy këndvështrimet. Si në këndvështrimin e projektit, që sikurse është parë, projektet e përgatitura dhe të zbatuara me përfshirjen e komunitetit lokal kanë qenë më të suksesshme. Ashtu edhe në këndvështrimin më të përgjithshëm, të politikave të qeverisë, si për shembull, mungesa e kohezionit social ka qenë një faktor i rëndësishëm, i cili ka penguar ecurinë afatgjatë të programeve për zhvillim.

Mësimi i tretë ka lidhje me institucionet dhe me një administratë të mirë publike. Përvoja shqiptare nënvizon paradoksin e dukshëm, që për të reduktuar rolin e shtetit dhe praninë e tij në aktivitetet prodhuese është e nevojshme që të forcohet shteti dhe institucionet e tij. Progresi jo i rregullt në reformat e administratës publike, si dhe në reformat ligjore dhe gjyqësore, rezultojnë në zgjerimin e aktiviteteve joligjore dhe jotransparente, në korrupsionin e përhapur kudo, dhe në mosbesimin e publikut ndaj qeverisë dhe institucioneve shtetërore.

Mësimi i katërt është se një program zhvillimi i suksesshëm kërkon një përpjekje të balancuar dhe të integruar. Në fillimet e viteve '90, rezultatet e mira të arritura në rehabilitimin e infrastrukturës dhe

përmbi të gjitha në privatizim, nuk u shoqëruan nga një progres domethënës në shëndetësi dhe edukim, si dhe në ngritjen e institucioneve dhe të qeverisjes. Rezultati ishte një rritje e shpejtë ekonomike, por një brishtësi e lartë e shoqërisë. Në pjesën e dytë të dekadës, vëmendja u zhvendos tek problemet shoqërore dhe institucionale, por përkeqësimi i infrastrukturës, si për shembull në sektorin e energjistikës, krijoi një bllokim për investimet dhe rritjen e mëtejshme.

Mësimi i pestë është se koordinimi i donatorëve është thelbësor për dy arsye. Së pari, për të lejuar donatorë dhe institucione të ndryshme të kontribuojnë sipas kualifikimit dhe përparësive të tyre konkurruese. Së dyti, për shkak të kostove të mbajtjes së lidhjeve me komunitetin ndërkombëtar dhe për të përshtatur procedurat dhe nevojat individuale, mund të shkaktojnë një pengesë shumë të vështirë për një vend. Në shumë raste unë kam parë Ministrin e Financave të Shqipërisë të preokupuar plotësisht nga nevoja për të mbajtur lidhje me institucionet ndërkombëtare dhe agjenci të ndryshme donatore. Procesi i PRSP dhe Kuadri i Zhvillimit të Mirëkuptimit ka mundësinë të përmirësojë dukshëm koordinimin e donatorëve.

Mësimi i gjashtë është që cilësia e projekteve të veçanta është e rëndësishme, por kjo nuk mund të garantojë suksesin e përgjithshëm të një programi për zhvillim. Shqipëria ka qenë një nga vendet më të suksesshme në kuadrin e ecurisë të projektit, por kjo nuk ka penguar kryerjen e shumë gabimeve të paparashikuara të programit, në përgjithësi, gjatë vitit 1996. Kjo nuk do të thotë që projekte të veçanta investimi duhet të braktisen, por ato duhet të integrohen në programin bazë, në të cilin investimet e veçanta janë shoqëruar me reforma më të gjera.

Mësimi i shtatë është se tiparet e vendit ku do të zbatohet programi nga institucionet ndërkombëtare janë kryesore, por, gjithashtu, edhe kushtëzimi është në shumë raste i rëndësishëm, dhe këto të dyja nuk duhet të jenë domosdoshmërisht vazhdim i linjës së filluar. Institucionet ndërkombëtare e detyruan Qeverinë Shqiptare të mbyllte skemat piramidale, por ndoshta nisma më të guximshme duhet të ishin marrë më parë. Po të kishte ndodhur kjo, kriza e vitit 1996, në njëfarë mënyre, mund të ishte zbutur, pavarësisht se ishte e pamundur që qeveria në atë kohë të kishte zgjedhur një drejtim të ndryshëm, edhe nën një presion më të madh ndërkombëtar. Gjithashtu, kushtet e përfshira në projekt për energjistikën kanë kontribuar në një progres të rëndësishëm në mbledhjen e faturave të energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë,

programi i ripërtëritjes nuk mund të çonte në rezultatet e ecurisë makroekonomike pa një angazhim aktiv dhe pa një pjesëmarrje të autoriteteve shqiptare në këtë program.

Dhe kjo më shtyn te komenti përmbledhës. Megjithëse unë kam besimin e thellë që Banka Botërore ka kontribuar shumë në zhvillimin e Shqipërisë, unë duhet ta shpreh qartë se merita më e madhe për sukseset e arritura, kryesisht, i përket shqiptarëve, sakrificave të tyre dhe zgjidhjeve të tyre për të ecur përpara edhe në situatat më të vështira.

## ANEKSI 1

### ECURIA E PROGRAMIT TË BANKËS BOTËRORE NË SHQIPËRI NGA 1991 –2001

Banka Botërore është përfshirë në krijimin dhe në zbatimin e reformave nëpërmjet politikave këshilluese, huadhënies dhe asistencës teknike. Që në fillimet e para, veprimet e saj, së bashku me ato të Fondit Monetar Ndërkombëtar, kishin për qëllim të arrinin tre objektiva politikë bazë. I pari, ishte të liberalizonte ekonominë, sistemin e çmimeve, regjimet e kursit të këmbimit dhe tregtare, si dhe të nxiste iniciativën në sektorin privat, konkurrencën e drejtë dhe disiplinën e tregut. I dyti, ishte të arrinte stabilizimin makroekonomik nëpërmjet politikave fiskale dhe monetare, që kishin për qëllim sigurimin e një balancimi të qëndrueshëm buxhetor dhe të sektorit të jashtëm. Objektivi i tretë ishte të krijonte institucionet dhe tregjet, nëpërmjet reformave strukturore në fushën e administrimit të taksave, të privatizimit, të thyerjes së monopoleve, reformave ligjore për pronësinë dhe pronat, rregullimeve bankare dhe të rrjetit të sigurimeve shoqërore për të mbrojtur të varfërit. Në vitet e para, si nga qeveria dhe nga Banka Botërore, vëmendje kryesore iu kushtua dy objektivave të parë.

#### I.1 NGRITJA E THEMELEVE TË NJË EKONOMIE TREGU

Në kohën kur iu bashkua institucionit, në vitin 1991, vendi ishte në një krizë të thellë. Asistenca ishte e nevojshme në të gjithë sektorët. Në këtë kuadër, përparësi ishin asistenca humanitare emergjente- ndihma në ushqime, përkrahja mjekësore dhe lënda e parë bujqësore kyçe – së bashku me stabilizimin makroekonomik. Projekti i Bankës Botërore mbi importet kritike dhe marrëveshjet *Stand By* me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të miratuar në vitin 1992, shënuan një hap thelbësor në braktisjen e planifikimit të centralizuar dhe në mbështetjen e programit të ristrukturimit të plotë të vendit drejt sistemit të bazuar në ekonominë e tregut. Nga ana tjetër, Banka Botërore njohu domodoshmërinë për të vepruar me donatorë dhe me agjenci të tjera. Shumë projekte u ideuan dhe u realizuan në bashkëfinancim me donatorë të tjerë. Për koordinimin më të mirë të aktiviteteve u organizuan disa takime për donacione dhe ndihma si dhe u ideua një program i veçantë për të mbështetur strategjinë e asistencës dhe programet e huadhënies. Asistenca e huaj ishte masive. Në pesë vite, nga viti 1992 deri në vitin 1996, Shqipëria mori si ndihmë totale rreth 1,525 miliardë dollarë amerikanë ose rreth 475 dollarë amerikanë për frymë, pjesa më e madhe e së cilës ishte dhuratë zyrtare (rreth 68 për

qind). Në të njëjtën kohë, të drejtat, angazhimet e IDA-s ndaj Shqipërisë arritën vlerën 272.5 milionë dollarë amerikanë ose rreth 18 për qind të ndihmës totale. Lëvrimet e IDA-s janë në vlerën e 123.6 milionë dollarë, 38 për qind e së cilës është shpërndarë për programin e asistencës teknike dhe 25 për qind për projektet e infrastrukturës. Duke marrë parasysh pasigurinë makroekonomike, zbatimin e dobët dhe kapacitetin e administratës publike, asistencën e IDA-s për vitet fiskale 1994-1996 ishte shumë e gjerë.

**Pikat kryesore të strategjisë së asistencës së IDA-s :**

Sektori	Objektivat	Natyra e përkrahjes së IDA-s (projektet dhe ESW)
Rehabilitimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike bazë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rehabilitimi</li> <li>• Mbulimi i kostove</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Energji</li> <li>• Transport</li> <li>• Ujësjellës</li> </ul>
Përkrahje për bujqësinë private	Shiko më poshtë	Shiko më poshtë
Sektori social dhe politikat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëvizja e sigurimeve shoqërore drejt bazës aktuariale</li> <li>• Një synim më i mirë për asistencën sociale</li> <li>• Zhvillimet e politikave për reduktimin e varfërisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrjeti i sigurisë sociale</li> <li>• Rehabilitimi i shkollave</li> <li>• Rehabilitimi i shëndetësisë</li> <li>• Tregu i punës</li> <li>• Varfëria urbane</li> <li>• Studimet mbi varfërinë</li> </ul>
Privatizimi, ristrukturimi dhe ristrukturimi i sektorit financiar	<ul style="list-style-type: none"> <li>➢ Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme</li> <li>➢ Zhvillimi i infrastrukturës dhe rregulloreve të bankës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektet e sektorit financiar dhe sipërmarrës</li> </ul>
Zhvillimet e administratës qendrore dhe lokale të re	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i kapaciteteve për përgatitjen dhe zbatimin e reformave</li> <li>• Përmirësimi i kapaciteteve absorbuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1994-1996 programi për investimet publike</li> <li>• Studim për reformat në shërbimet civile</li> <li>• Administrimi i taksave</li> <li>Plani i veprimtarisë së Administratës Publike</li> </ul>
Borxh i huaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shlyerja vullnetare e borxhit të Shqipërisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorime të Reduktimit të Borxhit (IDA)</li> </ul>

Burimi: Banka Botërore – Vlerësimi CAS i Shqipërisë, nëntor 2000.

Për shkak të vjetërimit të infrastrukturës së Shtetit Shqiptar, huatë e dhëna nga IDA u fokusuan në nevojat më urgjente të rehabilitimit fizik. Transporti dhe sektori i energjistikës u përcaktuan si përparësi kryesore. Pjesa më e madhe e angazhimeve të Bankës Botërore, rreth 21 për qind, u përqendrua në sektorin e transportit. Projekti për transportin dhe projektet për rrugët nacionale dhe rrugët rurale kanë për qëllim të përmirësojnë kushtet e rrugëve nacionale dhe rurale dhe të vendosin në këta sektorë reformat për politika të orientuara nga tregu.

Duke patur parasysh dobësitë institucionale në të dyja sistemet, si në atë të prodhimit, ashtu edhe të shpërndarjes, sektori i energjistikës ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga prioritetet kyçe të programit të Bankës Botërore. Në vitin 1993, kredia për importet kritike financoi rregullimet e menjëhershme të Hidrocentralit mbi lumin Drin. Përveç kësaj, projektet mbi reduktimin e humbjeve të energjisë dhe të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë kanë për qëllim të reduktojnë humbjet shumë të mëdha teknike dhe joteknike të energjisë, si dhe përdorimin joeficient të elektricitetit.

Sektori i dytë më i madh, që prezanton 19 për qind të angazhimeve totale, ishte sektori i bujqësisë, në të cilin Banka Botërore ndërhyri me gjashtë veprime huadhënieje dhe rregullimi, duke përfshirë kredi për ripërtëritjen e sektorit bujqësor, projektin për rehabilitimin e sistemit ujitës dhe projektin për zhvillimin e proceseve bujqësore.

Projekti më i suksesshëm ishte ai mbi zhvillimet rurale dhe programi pilot për zbutjen e varfërisë në zonat rurale, i cili prezanton mekanizma të rinj për t'u dhënë mundësi kreditimi fermerëve të vegjël. Projekti për pyjet ishte ideuar për të nxitur restaurimin dhe ruajtjen e ekosistemit natyral të pyjeve. Një mbështetje e veçantë në strategji i është dhënë reformave agrare, e cila ka për qëllim, gjithashtu, zhvillimin e tregut të tokave bujqësore. Të gjitha kooperativat shtetërore u shpërbënë dhe u krijuan rreth 450,000 ferma me një madhësi mesatare prej 1.1 hektarësh.

**Strategjia e Asistencës për Sektorin e Bujqësisë  
(1992 - 1996)**

Fusha/ nënsektorët	Detyrimet/ kushtet	Objektivat strategjikë
1. Reforma agrare	Përmasat e vogla të fermës.	Zhvillimi i tregut për privatizimin e tokës studim për sipërmarrjet bujqësore .
2. Sistemi ujitës	Gjendje fizike e varfër: institucione të papërshtatshme për ujitjen në shkallë të vogël.	Shtrirje e rrjetit të ujitjes. Mirëmbajtje e infrastrukturës së ujit. Krijimi i nxitjes për përdorimin eficient të ujit.
3. Krediti rural	BBZH/BTB nuk mund t'u jepte kredi fermerëve të vegjël.	Krijimi i lehtësirave për dhënien e kredive fermerëve të vegjël.
4. Infrastruktura rurale	Gjendja e varfër e shkaktuar nga dëmtimet dhe mungesa mirëmbajtjes.	Rehabilitimi i infrastrukturës rurale dhe përmirësimi i rrugëve rurale.
5. Inputet bujqësore	Mungesë e theksuar.	Zhvillimi i infrastrukturës dhe mundësimi i ambientit për të mbështetur tregtinë e sektorit privat.

Burimi: Banka Botërore – Vlerësimi CAS i Shqipërisë, nëntor 2000.

Në drejtim të zbutjes së varfërisë dhe të rrjeteve të sigurimit të shoqërisë janë kryer disa analiza për të zhvilluar kuadrin administrativ dhe ligjor për pensionet, për sigurimin e papunësisë dhe për sistemin e klasifikimit hierarkik të punëve. Ndërsa, pikësynimet afatshkurtra janë përqendruar në varfërinë e fshatit dhe mbi grupet më të brishta të shoqërisë, programi afatgjatë është drejtuar në krijimin e një sistemi të frytshëm për pensionet, zhvillimin e një mekanizmi për ndjekjen më nga afër të varfërisë dhe krijimin e një kornize të politikave për zbutjen e varfërisë dhe për reduktimin e mosbarazisë.

Duke mbajtur parasysh sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit, përpjekjet e para ishin direkt në rehabilitimin e spitaleve, në ripërcaktimin e zonave shëndetësore dhe në përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e kujdesit mjekësor bazuar në popullimin dhe në parametrat epidemiologjikë. Projektet *Rrjeti i Sigurisë së Shoqërisë* dhe *Zhvillimi i Tregut të Punës* ndihmuan duke krijuar politikën dhe kushtet institucionale për zhvillimin e një tregu pune më fleksibël.

Duke njohur dobësitë në fushën e Administrimit të Sektorit Publik dhe Zhvillimit të Institucioneve, IDA ka punuar me autoritetet dhe donatorë të tjerë për të ndihmuar në reduktimin e shërbimeve civile, duke zhvilluar kapacitetin absorbues dhe institucional të sektorit publik qendror dhe duke forcuar qeverisjen lokale nëpërmjet një procesi të ashtuquajtur decentralizimi me pjesëmarrje.

Projekti *Kreditë për Reformimin e Ndërmarrjeve dhe e Sektorit Financiar* mbështeti privatizimin e sipërmarrjeve shtetërore, duke përfshirë likuidimin dhe zvoglimin e ndërmarrjeve jofitimprurëse. Ndërsa deri në vitin 1996 u shitën 7500 ndërmarrje të mesme dhe të vogla, ndërmarrjet e mëdha shtetërore ishin më pak tërheqëse dhe procesi për tërheqjen e investitorëve ishte zhgënjyes. Dy operacionet e huadhënies, në sektorin urban dhe të strehimit, filluan një sistem strehimi bazuar në treg, duke krijuar rolin e sektorit privat.

Për të krijuar marrëdhënie normale me kreditorët, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore ndihmuan Shqipërinë në zhvillimin e strategjisë së administrimit të borxhit. Në mars të vitit 1995, Shqipëria arriti një marrëveshje me bankat kreditore, duke përdorur një drejtim rinovues që ristrukturoi borxhin, me principal prej 371 milionë dollarësh dhe interes të papaguar prej 111 milionë dollarësh, prej rreth vetëm 96 milionë dollarësh amerikanë ose rreth 20 centësh për dollar. Banka Botërore e zvogëloi këtë detyrim me 25 milionë dollarë dhuratë nga projekti i IDA-s, *Lehtësime në Reduktimin e Borxhit*. Si rezultat, borxhi i jashtëm u zvogëluar në 29 për qind të PBB-së në vitin 1996 nga 108 për qind në vitin 1992.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare kaloi transformime të mëdha strukturale dhe makroekonomike. Bilanci i pagesave u përmirësua konsiderueshëm dhe rezervat e valutave të huaja të bankës qendrore arritën nivele të mira prej rreth 3,5 muaj importesh. Inflacioni u reduktua shpejt, duke rënë nga 200 për qind në rreth 6 për qind në vitin 1995.

## **I.2 NË PËRGJIGJJE TË KRIZËS SË VITEVE 1996 DHE 1999**

Treguesit makroekonomikë u keqësuan konsiderueshëm në pjesën e dytë të vitit 1996. Deficiti fikal arriti në 10.5 për qind të PBB-së, krahasuar me një mesatare prej 7.5 për qind në tre vitet e fundit, pasi vendi ishte drejt zgjedhjeve të përgjithshme në verën e atij viti. Inflacioni u përshpejtua dhe monedha vendase u zhvlerësua. Në këtë klimë makroekonomike tashmë të pafavorshme shpërtheu

kriza e firmave piramidale. Përvoja e rritjes së menjëhershme të skemave piramidale nuk është unike për Shqipërinë, por në asnjë vend tjetër nuk rezultoi një rënie katastrofike në rregullin civil, si në Shqipëri. Skemat, pjesërisht u shfaqën si rezultat i një prapambetjeje në sistemin bankar, pasi asnjë bankë e ligjshme nuk do të kishte mundësi të ofronte interesa të krahasueshëm me ata të ofruar nga kompanitë që vepronin në skemat. Mungesa e familiaritetit të publikut të gjerë me çështjet financiare, gjithashtu, kontribuoi në zhvillimin e skemave. Fillimisht, rreziku i vërtetë i fenomenit u nënvleftësua madje dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, që fillimisht i trajtuan kompanitë si pjesë të tregut informal.

Meqë skemat fituan shumë popullaritet, shqetësimi filloi të shprehej veçanërisht nga Banka e Shqipërisë. Brenda Shqipërisë, në mes të viteve 1996, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë kundërshtoi me forcë në lidhje me rrezikun që fshihej në skemat dhe nxiti qeverinë dhe forcën e ligjit t'i mbyllte ato. Nga tetori i vitit 1996, nën presionin e fortë të Bankës së Shqipërisë dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Qeveria Shqiptare ra dakort të denoncojë publikisht rrezikun e skemave, por atëherë ishte vërtet shumë vonë. Në fillim të vitit 1997, të gjitha skemat u bllokuan, duke çuar në përhapjen e çrregullimit civil. Zyra e Bankës Botërore në Tiranë u evakua, për arsye të keqësimit të menjëhershëm të kushteve të sigurisë.

Niveli i skemave piramidale, krahasuar me përmasat e ekonomisë shqiptare ishte i paparashikuar. Është vlerësuar që mbi 65 për qind e popullsisë shqiptare kishte vënë kursimet në këto kompani mashtruese. Kostoja ekonomike e falimentimit vërtetoi të ishte shumë e lartë në kushtet e humbjeve të pasurive, të shkatërrimit të infrastrukturës dhe të pronës private, të mungesës së besimit ndaj institucioneve dhe mosbalancimeve të rënda makroekonomike. Në vitin 1997, PBB-ja ra rreth 7 për qind, inflacioni u përshpejtua në mbi 40 për qind dhe deficitin fiskal arriti 14 për qind të PBB-së. Bilancet e jashtme u keqësuan, ndihma e të huajve ishte tërësisht e përçarë dhe kishte një refuzim të mprehtë në hyrjen e kapitalit nga jashtë.

Në rrethana të tilla, rithemelimi i stabilitetit ekonomik, veçanërisht rimëkëmbja fiskale, ishte një rol strategjik kyç. Një tjetër përparësi ishte zbatimi i ligjeve bankare dhe i rregullimeve të kujdesshme. Sapo kushtet në Shqipëri u stabilizuan, shoqëruar nga ndërhyrja e një force ndërkombëtare për vendosjen e rendit, Banka Botërore miratoi në korrik të vitit 1997, një *Program Mbulimi* për të ndihmuar vendin të kthehej në një rrugë zhvillimi. Programi theksoi nevojën e

forcimit të kapacitetit administrativ të vendit, nëpërmjet një reforme në administratën publike, ndarjes së fuqisë ekzekutive dhe juridike, përmirësimeve në mbikëqyrje dhe transparencë, dhe pjesëmarrjes më të madhe të shoqërisë civile. Përparësi e lartë i ishte dhënë, gjithashtu, krijimit të pavarësisë së shërbimit civil, të pavarur nga ndikimi politik. Bazuar në një përditësim të hershëm të vlerësimit të varfërisë, hapa janë marrë gjithashtu nga IDA për të mbështetur grupet e dobta nëpërmjet restaurimit të shërbimeve shëndetësore dhe të edukimit.

Në vitin 1999, Shqipëria u prek nga kriza madhore, këtë herë nga ardhja e një numri të madh të shpërngulurish nga Kosova, të cilët sforcuan burimet e brendshme dhe rritën boshllëkun financiar. Banka Botërore asistoi Shqipërinë me një kredi shpenzimesh publike prej 30 milionë dollarësh, e cila e ndihmoi vendin të kapërcente krizat. Gjithashtu me këtë rast, stabiliteti makroekonomik u rivendos shpejt dhe rritja ekonomike rifilloi. Inflacioni u stabilizua dhe rezervat u rritën. Deficiti buxhetor u ul nga 11.4 në vitin 1999, në 9.1 për qind në vitin 2000 (Tabela II.1). Në të dyja rastet, Banka Botërore u habit nga aftësia e vendit për të vendosur stabilitet makroekonomik. Në të njëjtën kohë ishte, gjithashtu, e qartë që problemet shoqërore dhe të qeverisjes së vendit duhet të mbërtheheshin agresivisht për të siguruar mbështetje të programeve të zhvillimit.

### **I.3 RIORIENTIMI I PROGRAMIT TË BANKËS BOTËRORE PAS VITIT 1996**

Mësimet kryesore të këtyre krizave dolën në pah në Strategjinë e Asistencës për Vendin, miratuar në vitin 1998 si dhe në Raportin e Progresit të vitit 2000. Shkaqet kryesore të krizës, e cila nxori nga binarët procesin shqiptar të zhvillimit ishin: shteti jashtëzakonisht i dobët, mungesa e institucioneve të zhvilluara, angazhimi i ulët i vlerave të komunitetit dhe niveli i lartë i korrupsionit. Përprojekjet, megjithatë, janë përqendruar në tre prioritetet strategjike: (i) qeverisje dhe ndërtim i synuar institucional në krijimin e institucioneve shtetërore të përgjegjshme, transparente dhe eficiente, (ii) zhvillim të sektorit privat, i cili është vendimtar për rritjen dhe reduktimin e varfërisë; dhe (iii) zhvillimi human dhe zbutja e varfërisë. Përmirësime në qeverisje dhe në *ndërtimin institucional* drejtuan rritjen e transparencës të përgjegjësisë së shtetit në Shqipëri në mënyrë që të përmirësojë klimën e investimeve, të zbusë varfërinë dhe të ndërtojë besimin. Projektet kyçe në këtë kohë ishin projekti i reformës në administratën publike dhe projekti i reformës juridike dhe ligjore, të dy të miratuar në

mars të vitit 2000. Kreditë e para kishin për qëllim forcimin e shpenzimeve publike dhe administrimin e burimeve njerëzore në sektorët e institucioneve publike si dhe koordinimin e kapaciteteve brenda sektorit publik. Projekti i reformës juridike dhe ligjore siguron asistencë teknike, trainime dhe materiale për reformën e sistemit ligjor dhe juridik, në forcimin e rregullave të ligjit në Shqipëri. Përbërësit kryesorë janë: përmirësimi i arsimit në fushën ligjore, forcimi i sistemit të drejtësisë nëpërmjet përmirësimit të procesit të zbatimit të vendimeve gjyqësore, krijimi i një mekanizmi që trajton konfliktet tregtare.

### Qeverisja dhe ngritja e institucioneve

I. Forcimi i administratës publike dhe profesionalizimi i shërbimeve civile.	a) Zbatimi i rregulloreve të miratuara b) Rishikimi i funksioneve c) Zbatimi i reformës së pagave d) Shërbimi i kontrollit të shtetit i themeluar si një zyrë kombëtare e pavarur kontrolli.
II. Forcimi i gjyqësorit.	i. Rregullimi i zyrës së trupit gjyqësor ii. Trajnimi i gjykatësve iii. Riformulimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë iv. Legjislacioni të sigurojë kritere për emërimin apo pushimin nga puna të gjykatësve.
III. Forcimi i institucioneve lokale dhe krijimi i një konsensusi social.	1. Qeverisja lokale e trajnuar në punët e infrastrukturës dhe në metodat e këshillimit të popullatës .

Burimi: Banka Botërore – Shqipëri CAS, viti fiskal 1999-2001.

Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të Sektorit Privat kërkon veprime të koordinuara në disa drejtime (shiko tabelën e mëposhtme). Në fushën e infrastrukturës, Projekti për Rrugët Nacionale rehabilitoi dy seksione të rëndësishme të lidhjes ndërmjet Tiranës dhe Lezhës (në Korridorin e Veri Jugut) dhe lidhjen ndërmjet Tiranës dhe FYROM të Maqedonisë (në Korridorin Lindje Perëndim). Projekti për Rregullimet e Rrugëve Emergjente ka përmirësuar kushtet e rrugës *ekzistuese* që niset nga Durrësi për në Kosovë, të cilat ishin dëmtuar rëndë nga konflikti i Kosovës, ndërkohë që po financon një studim të mundshëm për një rrugë të re që Qeveria Shqiptare ka synim të ndërtojë. Së fundi, Projekti i Rrugëve Rurale ndryshoi mënyrën në të cilën bizneset veprojnë në sektorin e rrugëve në Shqipëri, duke krijuar një kapacitet kontratimi lokal, i cili nuk ekzistonte më përpara. Një fushë tjetër e rëndësishme e aktivitetit i përket Portit të Durrësit, i cili ndodhet në terminalin perëndimor të Korridorit të Tetë dhe është një pikë kyçe tranziti pothuajse për të gjitha eksportet dhe importet shqiptare si dhe për

trafikun për në Maqedoni dhe më tutje. IDA ka mbështetur transformimin e tij që në fillimet e vitit 1990. Arritjet e deritanishme përfshijnë miratimin e ligjeve për portin të orientuar ndaj tregtisë, krijimin e një autoriteti të pavarur të portit, veprimet e privatizimit të portit tashmë të nisura, përmirësimin me faza të metodave të trajtimit të ngarkesës së anijes dhe rehabilitimin/zëvendësimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve kyçe.

### Rifillimi i rritjes së mbështetjes të sektorit privat

<b>I. Stabiliteti makroekonomik</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmirësimi i administrimit të financave publike</li> <li>2. Përmirësimi i prioritetëve për të shpenzuar</li> <li>3. Reformat e pensionit dhe sistemi i të papunëve</li> </ol>
<b>II. Ndërmjetësimi financiar</b>	<p>Sektori bankar</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbyllja e Bankës Agrare, privatizimi i BKT; privatizimi i BK</li> <li>2. Miratimi i ligjit për bankat; legjislacioni i ri për kolateralin; forcimi i mbikëqyrjes bankare</li> <li>3. Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit</li> <li>4. Garancia për rrezikun politik</li> </ol> <p>Mikrokredia</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i fondacioneve autonome të mikrokredisë</li> <li>2. Kuadër legjislativ dhe mbikëqyrës për ShKV (Shoqëritë e Kreditit të Vogël)</li> </ol>
<b>III. Infrastruktura e energjistikës</b>  <b>Transportit</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Reduktimi i humbjeve në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë</li> <li>2. Pastrimi i borxheve të prapambetura të kompanive elektrike.</li> </ol> <p>Transportit</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i një komiteti ndërmintor për sigurinë e rrugëve</li> <li>2. Reduktime në punonjësit e hekurudhave dhe të shërbimeve</li> <li>3. Plani i veprimit për privatizimin e Portit të Durrësit</li> </ol>
<b>IV. Mbështetja e rritjes së bujqësisë</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ruatja e një tarife strukturore të ulët dhe uniforme</li> <li>2. Hyrja në OBT</li> <li>3. Heqja e Gdsr</li> <li>4. Infrastruktura bujqësore</li> <li>5. Shërbimet rurale dhe bujqësore</li> <li>6. Administrimi i burimeve natyrore</li> </ol>
<b>VI. Nxitja e zhvillimeve ambientaliste të qëndrueshme</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Plani i veprimtarisë ambientaliste kombëtare (NEAP) i përfunduar dhe i zbatuar</li> <li>2. Strategjia e biodiversifikimit dhe plani i veprimit i përfunduar</li> <li>3. Krijimi i detyrimeve të përbashkëta për ambientin</li> <li>4. Bordi i përbashkët i administrimit të liqenit të Ohrit</li> </ol>

Burimi: Banka Botërore – Shqipëri CAS, viti fiskal 1999-2001.

Për të zhvilluar *sektorin financiar* Gupi i Bankës Botërore ka qenë i ndërthurur në privatizimin e bankës, në mbikëqyrje dhe në infrastrukturën financiare. Banka Kombëtare Tregtare u privatizua. Projekti i krijimit të institucioneve për sektorin financiar, i miratuar në qershor të vitit 2000, do të asistojë pranë autoriteteve në zbatimin e reformës së sektorit. Aktualisht, Banka Botërore dhe IFC po asistojnë Shqipërinë në privatizimin e Bankës së Kursimeve.

Hapa konkretë janë ndërmarrë në rikapitalizimin dhe ruatjen e vlerës së bankës dhe përpjekje të mëtejshme janë në proces për të vendosur kontakte me investitorët e interesuar strategjikë dhe të kualifikuar. Për më tepër, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë ofruar asistencë teknike të gjerë, në bashkëpunim me autoritetet shqiptare dhe me organizata të tjera ndërkombëtare, në fusha të tilla si në tregun e letrave me vlerë të qeverisë, në krijimin e statistikave monetare dhe fiskale, në forcimin e rregullave të kujdesshëm dhe të mbikëqyrjes bankare.

Banka Botërore ka nxitur, gjithashtu, integrimin tregtar të Shqipërisë me zonat përreth. Në këtë aspekt, situata e re politike në Jugosllavi ofron një mundësi për bashkëpunim, dhe për zhvillim në integrimin ekonomik.

Për të lehtësuar procesin, Banka Botërore ka filluar një projekt për lehtësime të tregtisë dhe të transportit në vendet e Europës Juglindore, i cili është një nismë rajonale shumë e rëndësishme që ka për qëllim të forcojë dhe të modernizojë administratën e doganave (shih tabelën e mëposhtme). Ky projekt plotëson aktivitete të tjera, duke përfshirë korridoret kryesore, modernizimin e porteve, harmonizimin e kuadrit rregullator dhe ligjor, punën e përbashkët për të luftuar trafiket, korrupsionin dhe krimin e organizuar.

## **PROGRAMI PËR LEHTËSIMIN E AKTIVITETEVE NË TREGTI DHE TRANSPORT PËR EUROPËN JUGLINDORE (LTTEJ)**

Aktualisht, kostoja e lartë e tregtimit dhe e transportit në vendet e Europës Juglindore është një faktor dekurajues për investimet e huaja si dhe kosto përdorimi e lartë. Problemi më i dukshëm janë pritjet e gjata në kalimin e kufijve, që mund të zgjasin nga disa orë në disa ditë.

Programi për lehtësimin e aktiviteteve në tregti dhe në transport për Europën Juglindore (LTTEJ) e sjell më nga afër këtë problem, në baza rajonale. Vendet pjesëmarrëse kanë nënshkruar një memorandum për miratimin e themelimit të një komiteti drejtues rajonal (KDR). Progresi nën këtë program duhet të monitorohet nga treguesit e performancës të miratuar gjerësisht dhe të krahasohet në mbledhjet periodike të KDR-së.

Një përbërës kryesor i këtij programi është investimi në pikat e kalimit të kufijve. I një rëndësie të njëjtë është dhe thjeshtëzimi i procedurave dhe përmirësimi i shërbimit. Huatë e BERZH dhe kreditë e IDA janë miratuar në kuadrin e këtij programi: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia dhe Rumania. Projektet në Moldavi dhe në FYROM të Jugosllavisë janë në studim. Fondet për LTTEJ janë bazuar në bashkëpunim me donatorët e tjerë. Banka Botërore, kryesisht, merret me përmirësimet e shërbimit informativ dhe me lehtësime në kalimin e kufijve. Partneriteti me BE është një element thelbësor i LTTEJ. Shtetet e Bashkuara dhe donatorët e tjerë mbështesin përbërësit e lehtësimit të tregtisë dhe reformën e veprimeve doganore. UN ECE mban sekretarinë e KDR.

Një projekt i vogël, por përtëritës në favor të investimeve private ka qenë projekti për *Rimëkëmbjen e Industrisë Private*, i miratuar në vitin 1998. Agjencia zbatuese ASHG (Agjencia Shqiptare e Garancisë) ka emetuar rreth 20 garanci, për një total për më shumë se 6 milionë usd, me një ndikim pozitiv në investimet. Aktualisht, projekti është strukturuar që të përfshijë mbështetjen financiare dhe teknike për eksportet shqiptare. Kjo e transformon ASHG në një agjenci të kreditimit të eksporteve shqiptare. Përveç mbrojtjes ndaj rrezikut politik, për shkak të të cilit tani ka më pak kërkesë, falë aftësive për të përmirësuar klimën e përgjithshme, ASHG do të ofrojë: (i) sigurimin e kredive për eksportet dhe importet; (ii) garanci/ huaje për kapitalin qarkullues; (iii) lehtësime në ecurinë e eksporteve (v) asistencë teknike të sipërmarrjeve lokale për marketingun dhe për procedurat e eksportit.

*Zhvillimi Njerëzor dhe Zbutja e Varfërisë* përbën drejtimin e tretë strategjik bazë të Bankës Botërore. Në *sektorin e arsimit*, përpjekjet janë përqendruar në drejtim të administrimit të keq dhe të qeverisjes jo të përshtatshme dhe përgjegjshmërisë së sistemit. Masa të mëtejshme janë rekomanduar për të rritur shpërndarjen e financave për këtë sektor dhe cilësinë dhe efikasitetin e programit të arsimit. Në mënyrë të ngjashme, projekti 'reforma arsimore' ka për qëllim të përmirësojë administrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve edukative. Këto projekte, në përgjithësi, i kanë realizuar objektivat e tyre dhe kanë kontribuar ndjeshëm në progresin e reformës për sektorët përkatës. Në *sektorin e shëndetësisë* progresi ka qenë jo i kënaqshëm. Shërbimet vazhdojnë të jenë të papërshtatshme dhe të paarrtshme për pjesën më të madhe të fshatarësisë të varfër. Banka Botërore ka marrë përsipër të ndihmojë Shqipërinë në reduktimin e nivelit të lartë të varfërisë dhe të vdekshmërisë foshnjore dhe të fëmijëve, të përmirësojë planifikimin e sektorit shëndetësor, si dhe kapacitetet administruese dhe të rrisë eficiencën e shpërndarjes së financave për sektorin shëndetësor. SAC II do të kontribuojë në administrimin e shpenzimeve publike në sektorin e shëndetësisë, ndërsa studimi për sektorin e shëndetësisë do të sigurojë masa institucionale për të forcuar planifikimin e sektorit shëndetësor dhe kapacitetet administruese të tij.

#### **Zhvillimi njerëzor dhe zbutja e varfërisë**

<b>I. Forcimi i rrjetit të sigurimeve të shoqërisë.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e përfitimeve të asistencës sociale</li> <li>• Fillimi i LSMS (studim për matjen e standardit të jetesës).</li> </ul>
<b>II. Përmirësimi i cilësisë së arsimit.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reduktimi i niveleve të hierarkisë ndërmjet ministrisë dhe shkollave si dhe zvogëlimi i numrit të zyrave arsimore të rrethit.</li> <li>- Zhvillimi i metodave për vlerësimin e të mësuarit.</li> <li>- Ritrajnimi i mësuesve.</li> <li>- Rehabilitimi i shkollave të dëmtuara.</li> <li>- Racionalizimi i numrit të universiteteve, rritja e burimeve fiskale për shpenzimet jopaga.</li> </ul>
<b>III. Zhvillimi i një sistemi shëndetësor efektiv dhe të qëndrueshëm.</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përcaktimi i shërbimeve prioritare</li> <li>2. Forcimi i Ministrisë së Shëndetësisë si një organ rregullator dhe vendimmarrës.</li> <li>3. Transferimi kompetencave e planifikimeve dhe administrimeve rutinë në nivele më të ulta.</li> <li>4. Mbrojtja e paaftësisë paguese të sigurimeve shëndetësore.</li> <li>5. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore: mbulim, përdorim dhe rezultatet.</li> <li>6. Rritja e profesionalizmit – aftësive administruese. Standardet moderne në mjekësi.</li> </ol>

Strategjia e re, e ndjekur nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në Shqipëri mbështetet kryesisht në *Strategjinë e Rritjes dhe Reduktimit të Varfërisë*, që është zhvilluar direkt nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet konsultimit të gjerë me përbërës të ndryshëm të shoqërisë shqiptare. Strategjia pasqyron një sërë masash politike për të përmirësuar standardin e jetesës, dhe vendos objektiva për treguesit socialë, si dhe një mekanizëm për të matur dhe për të kontrolluar varfërinë. Politikat e ideuara trajtojnë problemet e kapacitetit institucional dhe qeverisë, të shëndetësisë dhe të arsimit, reformat gjyqësore dhe të administratës publike, nismën antikorupsion, asistencën sociale dhe varfërinë e fshatit. Edhe pse është në diskutim kapaciteti i Shqipërisë për të siguruar zbatimin në kohë të strategjisë, procesi mund të jetë i një rëndësie të veçantë në një vend me një shoqëri civile të copëzuar, sepse nxit proceset pjesëmarrëse në përcaktimin e programit dhe të projekteve të zhvillimit shtytës për komunitetin.

#### **I.4 NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT TË BANKËS BOTËRORE**

Që në fillim të programit me Shqipërinë, Banka Botërore ka miratuar 42 hua dhe ka përfunduar 22 projekte. Një tablo e shkurtër e huadhënies së Bankës Botërore dhe e treguesve kryesorë të varfërisë në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera, është paraqitur në tabelën II.2. Të dhënat tregojnë për një përfshirje të madhe të Bankës Botërore në aktivitetin kreditues në Shqipëri, si në numrin e projekteve ashtu edhe në nivelin e lëvrimeve. Angazhimet e IDA prekin shifrën 569.5 milionë dollarë dhe përdorimet 392.4 milionë dollarë. Ky është një nivel me të vërtetë i lartë i lëvrimeve në krahasim me programet e vendeve të tjera. Kapaciteti zbatues, në veçanti kapaciteti ndërmjetës (furnizues), ka qenë i ulët, por përmirësime janë bërë kryesisht në këto vitet e fundit si rrjedhojë e përpjekjeve të mëdha të mbikëqyrjes dhe e shpërndarjes së burimeve të mëdha për një monitorim më të detajuar të zbatimit të projektit nga Banka Botërore. Portofoli aktual përbëhet nga 20 projekte aktive për një total prej 249.5 milionë (tabela II.3). Nga këto, 20 për qind mbështesin bujqësinë, 44 infrastrukturën, 16 sektorin social, 20 asistencë teknike. Pjesa më e madhe e kritereve të ecurisë dhe e kushteve të programit janë përmbyshur dhe cilësia e portofolit të huasë së Bankës Botërore është përmirësuar që nga kriza e vitit 1997, ku pjesa e projekteve jo të suksesshme u rrit nga 10 në 20 për qind dhe kjo pjesë e përballua me një rrezik nga 30 deri në 65 për qind.

Objektivat më të mëdhenj të projektit u arritën. Megjithatë, qëndron problemi i qëndrueshmërisë afatgjatë që vjen për shkak të destabilizimit të rajonit dhe të mjedisit civil të vendit. Aktualisht, një nga projektet më të rëndësishme, projekti i transmisionit dhe i shpërndarjes së energjisë, është jo i kënaqshëm duke ju referuar objektivave të zhvillimit, por i kënaqshëm duke ju referuar progresit të zbatimit<sup>8</sup>. Një cilësi e kënaqshme e nivelit mbikëqyrës i është dhënë pjesës më të madhe të portofolit dhe masa të konsiderueshme janë në gjendje të sigurojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë.

**Tabela I.1. Treguesit e zgjedhur për ecurinë dhe administrimin e portofolit të Bankës Botërore.**

<b>Treguesit</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>
Vlerësimi i portofolit				
Numri i projekteve që po zbatohen	20	23	20	21
Periudha mesatare e zbatimit (vite)	2.77	3.03	2.73	3.02
Përqindja e projekteve me probleme në numër	25	21.74	10	14
Përqindja e projekteve me probleme në sasi	23.14	23.82	13.59	18.21
Përqindja e projekteve me rrezik në numër	30	21.74	10	14
Përqindja e projekteve me rrezik në sasi	29.69	23.82	13.59	18.84
Niveli i shlyerjeve	16.4	20.71	21.41	8.71
<b>Administrimi i portofolit</b>				
CPPR përgjatë vitit (po/jo)	Jo	PO	PO	PO
Burimet për mbikëqyrjen (totali në USD)	1,056.48	1,165.70	1,020.30	1,236.44
Shuma mesatare për mbikëqyrjen (USD/ projekt)	52.82	50.68	60.12	58.88

Një vlerësim interesant i progresit të reformave strukturore në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera në Europën Juglindore paraqitet në tabelën në vazhdim. Sikurse duket qartë edhe në tabelë, zhvillimi i sistemit bankar dhe forcimi i mjedisit rregullator dhe ligjor favorizues për investimet private në Shqipëri (indeksi i reformave në sipërmarrje) qëndron relativisht në një nga pikat më të dobëta dhe duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

<sup>8</sup> Njohja e angazhimit të qeverisë për të zbatuar strategjinë në sektorin e energjitikës e rishikuar nga komuniteti i donatorëve, në qershor të vitit 2001. IDA hoqi pezullimin e shlyerjeve për kreditimin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë dhe 10.5 milionë dollarë u rishpërndanë për të financuar blerjen e aparateve matës dhe për një studim të përgjithshëm në lidhje me investimet në të ardhmen, të nevojshme në këtë sektor.

**Tabela I.2 Progresi drejt reformave në sektorin real në rajonin e Europës Juglindore.**

Pjesa e sektorit privat ndaj PBB në për qind		Indeksi i reformave në sipërmarrje	Indeksi i politikave konkurruese	Indeksi i reformave të privatizimit	Indeksi i reformave bankare
Shqipëria	75	2.0	2.0	3.0	2.0
Bosnja Hercegovina	35	1.7	1.0	2.0	2.3
Bullgaria	57	2.3	2.0	3.0	2.0
Kroacia	60	2.7	2.0	3.7	2.3
FYROM	55	2.0	1.0	3.5	1.7
Rumania	60	2.0	2.0	3.0	2.0
Mesatarja	59	2.2	1.9	3.1	2.1

Raporti i tranzicionit të BERZH 1999, Indekset: 1 më e ulta dhe 4 më e larta.

Për aq sa mund të flitet për përkrahjen e sektorit privat, sot Grupi i Bankës Botërore ka investuar, nëpërmjet IFC, 47.5 milionë dollarë në 6 operacione, 31.5 milionë dollarë e të cilave janë investime në pajisje, në projekte të tilla si Nafta Petroleum Anglo- Shqiptare, FEFAD, BKT dhe Eurotech Cement. Strategjia e IFC –së në Shqipëri është përqendruar në sektorët strategjikë kyç, si për shembull naftë dhe gaz, minierat, veprimtari bankare dhe telekomunikacioni. IFC, gjithashtu, po ofron garanci pjesore për huatë dhe asistencë teknike në rishikimin e mjedisit investues. Gjithashtu, ata po asistojnë në forcimin e industrisë së sigurimeve duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator. Gjithashtu, MIGA ka filluar të veprojë në Shqipëri. Edhe pse, ekspozimi i saj i vogël, vetëm prej 8.6 milionë dollarësh amerikanë, nuk justifikon nevojën e madhe për investimet e huaja direkte dhe mundësitë në vend. Mbulimi i rrezikut politik për financimet tregtare të industrisë prodhuese, gjithashtu, është siguruar nga projekti i IDA *rimëkëmbja e industrisë private*, i miratuar nga bordi i Bankës Botërore në vitin 1998. Një përfshirje më intensive e të dyjave, e IFC dhe MIGA në Shqipëri, është çelësi i zhvillimeve për sektorin privat dhe për qëndrueshmërinë e përgjithshme ekonomike të Grupit të Bankës Botërore.

## REFERENCA

Banka e Shqipërisë, *Buletini Ekonomik*, 2/4 Qershor 2000  
Tiranë/Shqipëri.

Blejer, Mario, dhe të tjerë 1992. *Albania: From Isolation Toward Reform*, IMF Occasional Paper No.98 (Washington D.C, International Monetary Fund).

Fondi Monetar Ndërkombëtar - *Shqipëri: Enhanced Structural Adjustment Facility 1998-2001*, also PR No. 98/18, 13 Maj, 1998

Fondi Monetar Ndërkombëtar - *Shqipëri: Selected Issues and Statistical Appendix*, SM/01/203, 2 Korrik, 2001.

Fondi Monetar Ndërkombëtar - *Shqipëri: Staff Report for the 2001 Article IV Consultation and Review Under the Third Annual Arrangement Under the PRGF*, EBS/01/106, 2 Korrik, 2001

Fondi Monetar Ndërkombëtar - *Emergency Post Conflict Assistance for Albania 1997-1998*, PR 97/51, 7 Nëntor, 1997

Fondi Monetar Ndërkombëtar - *IMF Survey: IMF approves the second annual arrangement under the ESAF*, vol. 28/12, 21 Qershor, 1999.

Jarvis C. *The rise and fall of the pyramid schemes in Albania*. Materiale për stafin e FMN- s Vol 47/1, 2000, (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Washington, DC).

La Cava, Nanetti, Materiale teknike të Bankës Botërore No. 460, *Albania-Filling the Vulnerability Gap*, Shkurt 2000 (Banka Botërore Washington, DC).

Banka Botërore - Shqipëri: *Country Assistance Strategy*, Mars 1994.

Banka Botërore - Shqipëri: *Country Assistance Strategy FY99-01*, Korrik 30, 1998.

Banka Botërore - Shqipëri: *CAS Progress Report*, IDA/R2000-20, 29 Shkurt, 2000.

Banka Botërore - Shqipëri: *Country Assistance Evaluation*, Report No. 21390, 16 Nëntor, 2000, OED.

Banka Botërore, KE, FMN, BERZH - Shqipëri, EC, EBRD, IMF - *Albania: Directions for Recovery and Growth*, Korrik 1997.

Banka Botërore - Shqipëri: *Interim PRSP and Joint World Bank – IMF Staff assessment of the PRSP*, IDA/SecM2000-263, 16 Maj, 2000.

Banka Botërore - Shqipëri: *Performance Audit Report – Rural Poverty Alleviation Pilot Project*, No.13819, 12 Dhjetor, 1994.

Banka Botërore - *Anticorruption in Transition – A World Free of Poverty*, Shtator 2000.

Banka Botërore - *Attacking Poverty – World Development Report 2000/2001*, Shtator 2000, (Oxford University Press, NY).

Banka Botërore - *Building Institutions for Markets – World Development Report 2002*, Shtator 2001, (Oxford University Press, NY).

Banka Botërore - *Entering the 21<sup>st</sup> century – World Development Report 1999/2000*, Gusht 1999 (Oxford University Press, NY).

Banka Botërore - *Global Economic Prospects and the Developing Countries – Beyond Financial Crisis 1998/99*, Dhjetor 1998.

Banka Botërore - *Helping Countries Combat Corruption – Progress at the World Bank since 1997*, OCS/PREM, Qershor 2000.

Banka Botërore - *Making Transition Work for Everyone, Poverty and Inequality in Europe and Central Asia*, Gusht 2000.

Banka Botërore - *The IFC Difference – IFC 2001 Annual Report*, Shtator 2001.

Banka Botërore - *The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe* – Një material për strategjinë e rajonit, Mars 2000, ECA Region.

Banka Botërore - *World Development Indicators – 2001*, Prill 2001.